


LegalNews

October 2024
Tetor 2024



Deloitte.

Udhëzim Nr. 757, datë 30.9.2024 "Për Procedurat e Shqyrtimit, Vlerësimit dhe Miratimit të Kërkesave për Licencim të Subjekteve që Kryejnë Veprimtari të Ndërmjetësimit në Tregun e Punës dhe Monitorimin e Tyre" (referuar më tej si "**Udhëzimi Nr. 757 ose Udhëzimi për Licencimin dhe Monitorimin**").

Në vijim të ndryshimeve të miratuara rishtas të kriterëve dhe procedurave për licencimin e aktiviteteve që lidhen me ndërmjetësimin në tregun e punës, autoriteti përgjegjës për licencimin, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni (MEKI) ka miratuar Udhëzimin për Licencimin dhe Monitorimin.

Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë procedurat për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave për licencim të subjekteve private që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi në tregun e punës dhe monitorimi i tyre në vijimësi pas licencimit.

Pikat kryesore të Udhëzimit për Licencimin dhe Monitorim janë:

1. Qartësimi i dokumentacionit provues për Kriteret e Licencimit: Të gjitha subjektet që kërkojnë apo aplikojnë për licencë nën kategorinë X.2.A, duhet të përmbushin disa kërkesa specifike, përfshirë një kapital sigurie për të tretët në masën e pesë pagave minimale apo kriterëve për drejtuesit teknikë të subjekteve. Dokumentacioni vërtetues duhet të jetë origjinal ose i njehsuar me origjinalin dhe të përfshijë përkthime të certifikuara kur është e nevojshme.

Instruction No. 757, dated 30.9.2024 "On Procedures for Reviewing, Evaluating, and Approving Licensing Applications of Entities Engaged in Employment Intermediary Activities and Their Oversight" (hereinafter referred to as "**Instruction No. 757 or the Licensing and Monitoring Instruction**")

Following the recent changes of the criteria and procedures for the licensing of the activities related to employment market intermediation, the responsible authority for the licensing, the Ministry of Economy, Culture and Innovation (MECI) has enacted the Licensing and Monitoring Instruction.

The purpose of this Instruction is to determine the procedures for the review, evaluation and approval of the applications of the entities providing employment intermediation services.

Key Provisions of the Licensing and Monitoring Instruction include:

1. Clarification of the evidentiary documents for Licensing Criteria: All entities seeking or applying for a license under subcategory X.2.A must meet specific requirements, including maintaining a security capital for third parties in the amount of five minimum salaries and criteria for technical directors of these entities. The evidentiary documents for licensing criteria must be original or certified copies and should include certified translations if needed.

2. Procedurat e Aplikimit, Shqyrtimit dhe Vendimmarrjes:

Procesi i aplikimit dhe shqyrtimit për licencimin e subjekteve që operojnë në fushën e ndërmjetësimit të punës përfshin hapat e mëposhtëm:

i. Aplikimi për Licencim:

Subjektet që kërkojnë të pajisen me licencë për veprimtari ndërmjetësimi në tregun e punës (*nënkategoria X.2.A*) dorëzojnë aplikimin elektronikisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

QKB i përcjell elektronikisht aplikimet Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Migracionit për shqyrtimin e plotësisë së dokumentacionit.

ii. Shqyrtimi i Dokumentacionit:

Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Migracionit verifikon plotësinë e dokumentacionit. Në rast se dokumentacioni është i plotë dhe përputhet me kërkesat ligjore, aplikimi kalon për inspektim.

Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, kërkesa mund të refuzohet dhe subjekti njoftohet për vendimin.

iii. Inspektimi në Vend:

Inspektorati Shtetëror i Punës kryen inspektimin në vend për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të licencimit. Inspektimi përfshin

2. Application, Review, and Decision-Making Procedures:

The process of application and review for the licensing of entities operating in the field of employment intermediation involves the following steps:

i. Application for Licensing:

Entities seeking a license for employment intermediation activities (subcategory X.2.A) must submit their application electronically via the National Business Center (NBC).

The NBC forwards the applications to the Directorate of Employment and Migration Policies for a review of the completeness of the documentation.

ii. Review of Documentation:

The Directorate of Employment and Migration Policies verifies the completeness of the submitted documentation. If the documentation is complete and meets the legal requirements, the application proceeds to the inspection phase.

If the documentation is incomplete, the request may be rejected, and the entity is notified of the decision.

iii. On-Site Inspection:

The State Labor Inspectorate conducts an on-site inspection to verify compliance with the licensing criteria. The inspection

shqyrtimin e dokumentacionit dhe verifikimin faktik në ambientet e subjektit.

Rezultatet e inspektimit dokumentohen në procesverbalin e vlerësimit, në përputhje me shtojcën e bashkëngjitur në Udhëzimin Nr. 757. Procesverbali i vlerësimit i dorëzohet drejtorisë përkatëse brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

iv. Vendimmarrja për Licencimin:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe inspektimit, dosja e aplikantit kalon për miratim te ministri. Nëse plotësohen të gjitha kriteret dhe inspektimi është i suksesshëm, ministri merr vendimin për miratim të kërkesës për licencim.

Vendimi për miratim ose refuzim publikohet në QKB, e cila pajis subjektin me licencë për veprimtari ndërmjetësimi sipas nënkategorisë X.2.A.

3. E Drejta për Ankim: Në rast të refuzimit, subjekti ka të drejtë të paraqesë ankim brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 30 të Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "[Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë](#)", i ndryshuar.

involves a review of the documentation and a factual verification at the entity's premises.

The inspection results are documented in an evaluation report, in accordance with the annex attached to Instruction No. 757. The evaluation report is submitted to the relevant directorate within 7 (seven) days from the completion of the inspection.

iv. Licensing Decision:

After the review of the documentation and the on-site inspection, the applicant's file is submitted to the Minister for approval. If all criteria are met and the inspection is successful, the Minister issues a decision approving the licensing request.

The decision, whether approval or rejection, is published by the NBC, which then issues the entity a license for employment intermediation activities under subcategory X.2.A.

3. Right to Appeal: In the event of a rejection, the entity has the right to file an appeal within 10 days of receiving the notification, following the procedures specified in Article 30 of Law No. 10081, dated 23.2.2009, "[On Licenses, Authorizations and Permits in the Republic of Albania](#)," as amended.

4. Raportim dhe Monitorim

Periodik: Subjektet e licencuara janë të detyruara të dorëzojnë raporte të detajuara çdo 6 (gjashtë) muaj mbi aktivitetin e tyre, përfshirë numrin e individëve të ndërmjetësuar dhe subjektet punëdhënëse. Gjithashtu, subjektet duhet të mbajnë regjistra për çdo person të ndërmjetësuar dhe të dhëna mbi punëdhënësit, në përputhje me standardet e licencimit. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Drejtoria përkatëse do të kryejnë monitorime të rregullta për të garantuar përmbushjen e kushteve të përcaktuara. Në rast të mosrespektimit të kushteve, licenca mund të pezullohet ose revokohet.

Udhëzimi për Licencimin dhe Monitorimin ka hyrë në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare nr. 169 të datës 04.10.2024.

4. Periodic Reporting and

Monitoring: Licensed entities are required to submit detailed reports every 6 (six) months on their activities, including the number of intermediated individuals and the employing entities. Entities are also required to maintain records for each intermediated person and data on employers in compliance with licensing standards. The State Labor Inspectorate and the relevant Directorate will conduct regular monitoring to ensure compliance with established requirements. In cases of non-compliance, the license may be suspended or revoked.

The Licensing and Monitoring Instruction entered into force upon publication with the Official Gazette no. 169 dated 04.10.2024.

Ndryshime në rregulloren "Për Administrimin e Rrezikut në veprimtarinë e Subjekteve Financiare Jobanka"

Vendimi Nr. 47 publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 09.10.2024, i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, sjell ndryshime të rëndësishme në Rregulloren për Administrimin e Rrezikut për subjektet financiare jobanka (referuar më tej si "**Rregullorja**"), me fokus të veçantë në praktikat e kredidhënies për konsumatorët.

Disa nga pikat kryesore të vendimit janë si vijon:

Përkufizimet

Rregullorja përfshin përkufizime të reja për konceptet "*konsumator*" dhe "*kontratë e kredisë konsumatore*", në përputhje me Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 "*Për Mbrojtjen e Konsumatorit*", i ndryshuar.

Kërkesat për Kredidhënien ndaj Konsumatorëve

Subjektet financiare jobanka duhet të vlerësojnë me rigorozitet aftësinë paguese të konsumatorëve, përfshirë stabilitetin e të ardhurave, historikun e pagesave dhe detyrimet e tjera financiare përpara dhënies së kredisë.

Gjithashtu, këto institucione janë të detyruara të sigurojnë informacion të domosdoshëm, me pëlqimin e konsumatorit, dhe të verifikojnë saktësinë e tij, sidomos për individët e vetëpunësuar apo me të ardhura sezonale.

Amendments to the Regulation "On Risk Management in the activity of Nonbank Financial Institutions"

Decision No. 47, published in the Official Gazette No. 171, dated 09.10.2024, approved by the Supervisory Council of the Bank of Albania, introduces significant amendments to the Regulation on Risk Management for nonbank financial institutions (hereinafter referred to as the "**Regulation**"), with a particular focus on lending practices for consumers.

Some of the main points of the decision are as follows:

Definitions:

The regulation now includes new definitions for the concepts "*consumer*" and "*consumer credit agreements*," in alignment with the Law No. 9902, dated 17.4.2008 "*On Consumer Protection*", as amended.

Requirements for Consumer Loaning:

Nonbank financial institutions must rigorously assess consumers' repayment capacity, including income stability, payment history, and other financial obligations, before issuing loans.

In addition, these institutions are obligated to obtain essential information, with the consumer's consent, and verify its accuracy, especially for self-employed or seasonally employed individuals.

Çdo subjekt financiar jobankë duhet të konsiderojnë skenarë të mundshëm si rritja e normave të interesit dhe luhatjet e kursit të këmbimit në analizën e tyre financiare.

Kufizimet në Kontratat e Kredisë Konsumatore

Kontratat e kredive konsumatore nuk mund të lidhen me individë nën moshën 18 vjeç, persona me kapacitet të kufizuar vendimmarrje, apo në oraret nga ora 22:00 deri në 07:00.

Subjektet financiare jobankë nuk mund të lidhin kontrata të kredisë konsumatore me persona të cilët rezultojnë në regjistrat e krijuar nga subjektet për personat që nuk lejohen të lidhin një kontratë kredie, si dhe nuk mund të ekspozohen me më shumë se 2 kredi konsumatore ndaj të njëjtit kredimarrës, në të njëjtën kohë.

Institucionet e Mikrokredisë

Këto kërkesa zbatohen gjithashtu për institucionet e mikrokredisë, duke siguruar standarde të njëjta të kredidhënies për konsumatorët në të gjithë sektorin financiar.

Burimet e Shlyerjes

Një ndryshim tjetër thekson se burimi i shlyerjes së detyrimit të kredive nuk duhet të jetë një kredi tjetër.

Këto ndryshime hyjnë në fuqi më 01.01.2025 dhe do të zbatohen për të gjitha subjektet financiare jobanka të licencuara për kredidhënie, si dhe për institucionet financiare të mikrokredisë.

Each nonbank institution must consider possible financial scenarios, such as rising interest rates and currency fluctuations, in their financial analysis.

Restrictions on Consumer Credit Agreements

Consumer credit agreements cannot be established with individuals under the age of 18, individuals with limited decision-making capacity, or during specific hours (from 22:00 to 07:00).

Nonbank financial institutions shall not conclude consumer credit agreements with individuals resulting in the registers created by the entities for persons who are not allowed to conclude a loan agreement and may not be exposed to more than 2 consumer credit agreements to the same borrower, at the same time.

Microcredit Institutions

These requirements also apply to microcredit institutions, ensuring consistent consumer loaning standards across the financial sector.

Repayment Sources

Another amendment clarifies that the source for repaying credit obligations must not be another loan.

These changes will enter into force on 01.01.2025 and will apply to all nonbank financial institutions licensed for loaning, as well as to microcredit financial institutions.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Ened Topi

Legal Senior Managing
Associate
Deloitte Legal sh.p.k

“Rruga e Kavajës”,
Ish parku i mallrave,
Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 3
1001, Tirana, Albania
Mob: +355 69 23 87 494
E-mail: etopi@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing’s affiliates (collectively the “Deloitte Network”) are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte’s approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.